



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 01 mars 2019

Z. Pleurat Sejdiu, Kryetar  
Oda e Mjekëve të Kosovës  
Rr. Kosta Novaković  
Kontejneri nr. 3, zyra nr. 214  
10000 Prishtinë

## LETËR REKOMANDIM

Ankesa nr. 818/2018

NN

kundër

Odës së Mjekëve të Kosovës

I nderuari z. Sejdiu,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 6 nëntor 2018, ka pranuar ankesë kundër Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK).

Sipas informatave të pranuar nga ankuesi kuptohet që OMK-ja, më 5 korrik 2018, ka nxjerrë Vendim nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative. Më tej, ankuesi ka pohuar se më këtë vendim është vendosur që “Taksa administrative për inicimin e procedurës disiplinore ndaj mjekëve të jetë në shumën 30€ (tridhjetë euro)”. Për më shumë, ankuesi pretendon se një vendim i tillë shkel të drejtat e njeriut, ngase detyrimi për pagimin e taksës bëhet pengesë për pacientët që të paraqesin ankesë kur konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat nga personeli mjekësor.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, më 4 dhjetor 2018, ka dërguar shkresë dhe ka kërkuar informacione nga OMK-ja për bazën ligjore dhe për qëllimin e vendimit në fjalë.

Më 7 dhjetor 2018, OMK-ja ka kthyer përgjigje dhe ka njoftuar se Vendimi nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative mbështetet në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafët 1.12 dhe 1.13 të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (në tekstin e mëtejshëm *Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë*), si dhe në nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafët 1.12 dhe 1.13 të Statutit të OMK-së (në tekstin e mëtejshëm *Statuti*).

Avokati i Popullit vëren se neni 19 i Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë përcakton Kompetencat e Kuvendit, ndërsa paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe nënparagrafi 1.13 përcaktojnë, si në vijim:

“... lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e Odës (1.12);

“... lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e Odës, taksën për licencim dhe rilicencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare” (1.13).

Avokati i Popullit vëren se neni 22 i Statutit përcakton *Kompetencat e Kuvendit*, ndërsa paragrafi 1, nënparagrafët 1.12 dhe 1.13 përcaktojnë si në vijim:

“... lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e OMK-së” (1.12);

“...rregulloren për lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e OMK-së, taksën për licencim dhe rilicencim, si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera, për të cilat OMK mban evidencë zyrtare” (1.13).

Avokati i Popullit me këtë rast tërheq vëmendjen tek Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarit në Kujdesin Shëndetësor, si dhe tek Udhëzimi Administrativ 15/2013 Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Pacientit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32, përcakton se: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*”

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 13, përmban “*Parimin e të drejtës në mjete juridike*”, sipas të cilit, “*secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative, (...) kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë (...)*”, ndërsa neni 12 përmban “*Parimin e mospagimit të procedurës*”, sipas të cilit, në paragrafin 1 përcaktohet: “*Për palën, procedura administrative është pa pagesë (...)*.”

Për më tepër, Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, neni 24, rregullon të drejtën për ankesë, sipas të cilit përcaktohet:

“*Qytetari ka të drejtë të parashtojë ankesë ndaj institucionit shëndetësor përkitazi me shërbimin shëndetësor që i është ofruar, jo më vonë se 60 ditë pas shkaktimit të incidentit.*” (24.1.)

“*Institucioni shëndetësor duhet të bëjë hetime lidhur me pohimet në ankesë dhe duhet të informojë qytetarin mbi rezultatet e hetimeve me shkrim, brenda 10 ditëve të punës.*” (24.2).

Ndërsa Udhëzimi Administrativ 15/2013 Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Pacientit, shtojca 1, neni 13, përcakton:

“*Çdo qytetar ka të drejtën për t’u ankuar sa herë që pëson dëm fizik, moral dhe psikologjik. Po ashtu ka të drejtë për të marrë përgjigje në ankesën e tij.*”

Avokati i Popullit pohon se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj institucionit shëndetësor është procedurë administrative, e cila mund të rregullohet me rregulla të brendshme, mirëpo ato rregulla duhet të jenë në harmoni të plotë me dispozitat e përgjithshme ligjore.

Siç është cekur më lart, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se “Për palën, procedura administrative është pa pagesë (...).”

Avokati i Popullit konstaton se çdo obligim i qytetarëve për të paguar taksë për paraqitjen e ankesës ndaj institucionit shëndetësor përbën cenim të së drejtës kushtetuese për përdorimin e mjeteve juridike, e po ashtu cenon dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe cenon të drejtën për të paraqitur ankesë, e cila është e garantuar me dispozitat e Ligjit nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve dhe në Kujdesin Shëndetësor dhe me Udhëzimit Administrativ 15/2013 Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Pacientit.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në dispozitat e sipërpërmendura, vlerëson se pacientët duhet të jenë të lirë të paraqesin ankesa ndaj institucionit shëndetësor/personelit të institucionit shëndetësor, nëse e konsiderojnë se u janë cenuar të drejtat e garantuara.

Avokati i Popullit vlerëson se baza ligjore në të cilën është mbështetur Vendimi nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative, nuk përmban ndonjë dispozitë e cila ia lejon OKM-së caktimin e rregullave të tilla, të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura, kushtetuese dhe ligjore.

Avokati i Popullit konstaton se OMK-ja mund të caktojë çfarëdo tarife për anëtarët e OMK-së, mirëpo në asnjë rrethanë nuk mundet t’i kufizojë qytetarët për paraqitjen e ankesave ndaj personelit të institucionit shëndetësor me pagesën e taksës.

Avokati i Popullit thekson se qytetarëve duhet t’u mundësohet që lirshëm të paraqesin ankesë ndaj personelit të institucionit shëndetësor, nëse konsiderojnë se u janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i:

## REKOMANDON


### Odës së Mjekëve të Kosovës

1. *Ta pezullojë menjëherë zbatimin e paragrafit 8 (tetë) të Vendimit nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative, i datës 7 korrik 2018.*
2. *Ta ndryshojë Vendimin nr. 270/2018 për Caktimin e Sistemit të Taksave Administrative, i datës 7 korrik 2018, duke fshirë në tërësi, paragrafin 8 (tetë), i cili përcakton: “Taksa administrative për inicimin e procedurës disiplinore ndaj mjekëve në shumën prej 30.00 (tridhjetë) eurosh”.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’ia paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutem na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit